



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS (ATK) - Divizioni i Ankesave – në përbërje të panelit shqyrtues të kryesuar nga Xhevdet Neziri, anëtarë të panelit Bashkim Paçarizi dhe Seide Berisha anëtare dhe procesmbajtëse, duke vendosur në çështjen administrative tatimore, sipas ankesës së subjektit “Shtetliq Lohaj”, me numër fiskal NF: 602810008, me adresë të biznesit në fshatin Mirash - Ferizaj, e dorëzuar në Divizionin e Ankesave me datë 15/09/2022 me nr. protokolli 400/2022, kundër Raportit të Kontrollit pn. datë 02.11.2022, për Tatimin Shtesë, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Ferizaj, në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, në seancën dëgjimore të mbajtur me datë 05.12.2022, në prezencë të palëve: Bashkim Lohaj pronari, Burhan Qosa avokati i tatimpaguesit, inspektor kontrollit Besim Gashi, mori këtë:

V E N D I M

I. Apropohet pjesërisht si e bazuar ankesa nr.460/2022 të datës 02.11.2022 e tatimpaguesit, në “Shtetliq Lohaj”, me numër fiskal NF: 602810008, me adresë të biznesit në fshatin Mirash – Ferizaj, në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4, të Ligjit Nr. 05/L-031 “Për Procedurën Administrative” në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit Nr. 03/L-222 “Për Administratën Tatimore dhe Procedurat”, dhe Njoftim Rivlerësimet e tatimit shtesë nga kontrolli vërtetohen si të bazuara.

II. Ndryshohen Njoftim Rivlerësimi për Tatim në të Ardhurat Personale për vitin 2018, 2019, 2021, Pjesa e mbetur pas ndryshimeve mbetet obligim për pagesë për tatimpaguesin.

III. Procedura e ankesës nuk ndërprejë obligimin e tatimpaguesit për pagesë të detyrimeve tatimore (tatim, ndëshkime dhe interes) në përputhje me nenin 9, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 04/L-102 për Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë në Divizionin e Ankesave me postë me datën 27/10//2022, kurse në Zyrën e Divizionit të Ankesave ka mbërrirë me dt.02.11.2022, ndërkaq Njoftim Rivlerësimet nga Kontrolli dhe Procedurën e ankesës e ka pranuar më datë /08/2022, që për rrjedhojë ankesa është parashtruar në afatin ligjor prej 30 ditësh e përcaktuar me nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222 ”Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore”.

Kontrolli: Arsyetimi i hapjes së kontrollit është përzgjedhje nga Njësia Rajonale e Hetimeve dhe Krimeve Ekonomike të Kosovës.

Kontrolli ka filluar me datë:26/08/2022 dhe ka përfshirë Tatimin në Vlerën e Shtuar periudha: 01/2018 – 12/2021, Tatimi në të Ardhurat Personale, (PD periudha 2015 - 2021, (CI) periudha 2015 - 2021.

Në pajtim me nenin 7 paragrafi 2 i ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe nenin 44 paragrafin 7, të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 për zbatim të ligjit nr.03/L-222 në afatin e paraparë ligjor paraqesim këtë ankesë :
Ndaj vendimit për Raport Kontrollit I datës 29.09.2022 me nr 90-276/2022

- Gjate periudhës se kontrollit deponimet e gjetura ne banke janë tatimuar pa ju llogarit asnjë kosto janë marr si te hyre complete ndërsa nuk na është dhënë rasti qe përmes transkriptove te mesazheve dhe bisedave telefonike te marren si fakte qe dëshmojnë se ato mjete nuk janë mjete te mia mirëpo vetëm një përqindje e caktuar për arsye se un kam operuar si ndërmjetësues andaj kërkojmë nga ATK qe te na jep ndonjë dokument me te cilin mund te ofrojmë ne PTK si dëshmi për nxjerrjen e këtyre transkriptove.

- Pik tjetër qe vlen te përmendet është se individi merret me Kripto Valuta dhe meqenëse janë ende te pakuptueshme për shume institucione dhe nuk ka ndonjë ligj te veçanta për këto ne mendojmë se këto te hyra janë sikurse çdo Kembimore e monedhave tjera te pranueshme andaj shërbimi i kem bimores është Furnizim i përjashtuar pa te drejt kreditimi andaj këto te hyra nuk duhet tatimohen me 18% mirëpo me shkallë 0%

Divizioni i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L – 031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit më datë 05/12/2022, në të cilën ti pranishëm ishin të gjitha palët e ftuara. Përfaqësuesi i tatimpaguesit në të drejtën e fjalës e mbështet ankesën e parashtruar me shkrim.

Konsiderojmë se ankesa është e qartë sepse nga Raporti i Kontrollit nuk është prezantuar fitimi real i tatimpaguesit sepse ato mjete të deponuara nuk paraqesin fitimin real sepse tatimpaguesi është marrë me kriptovaluta dhe fitimi është 2 – 3%.

Tatimpaguesi deklaron se deponimet nuk janë ardhë nga mjetet e tije por nga mjetet e të tjerëve që kanë dashur të blejnë kripto valuta, por nuk kanë pasur llogarit, parat e deponuara janë konvertuar menjëherë në kripto në emër të personit që ka dhënë parat. Pra veprimtaria e jonë është ndërmjetësimi.

Inspektori i kontrollit në të datën e fjalës potencoi se arsyeja e kontrollit ka qenë informatat nga palët e treta.

Pretendimi në ankesën e tatimpaguesit është potencuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontrollit, mirëpo ne jemi mbështetur vetëm në të dhënat e bankës (deponimet) tatimpaguesi nuk ka tërheqje.

Administrata Tatimore – Divizioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë si dhe pretendimeve ankimore konstaton se: Ankesa e tatimpaguesit është pjesërisht e bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:
Divizioni i Ankesave pas vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës si: Raporti i Kontrollit nr.14251, datë 29/09/2022, Njoftim Rivlerësimeve pas kontrollit, Fletave të Punës së Kontrollit, Intervistës fillestare me pronarin, Llogarit bankare dhe analizimit të pretendimeve ankimore nga të njëjtat nxjerr konstatimin, se ATK-Drejtoria Rajonale, e Ferizajt, ka kryer kontrollin tek subjekti “Shkumbin Lohaj” me NF: 602813968, (PD) - tatim shtesë për periudhat tatimore 2015– 2021, në vlerë prej 4,646.85 dhe (TVSH) - tatimi shtesë në vlerë prej 4,764.14€, (CI) Tatim shtesë 3,818.00€, pa ndëshkime dhe interes (vlera të marra nga raporti i kontrollit).

Kontesti i Tatimpaguesit për Tatimin shtesë për TVSh-ë, Tatimin në të Ardhurat Personale, dhe CI – dhe Kontribute Pensionale për pronarin për periudhën 2015 – 2021 pa ju llogarit asnjë kosto - Divizioni i Ankesave pas analizimit të dosjes në dispozicion dhe dispozitave ligjore që e rregullojnë çështjen në fjalë konstaton se mbetet në fuqi pjesërisht vlerësimi i kontrollit.

Këtë konstatim Divizioni i Ankesave e mbështet bazuar në informatat te palët e treta për periudhën 2015 – 2021, si dhe dispozitave ligjore si Ligji 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat Neni 1.1 i cili nen citon:

1.1. Aktivitet ekonomik- çdo aktivitet te prodhuesve, tregtarëve ose personave që furnizojnë mallra dhe shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, si dhe aktivitetet e profesioneve. Eksploatimi në baza të vazhdueshme i pasurive të prekshme ose të pa prekshme me qëllim të sigurimit të të ardhurave në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik.

Divizioni i Ankesave vërteton se kontrolli bazuar në informatat nga llogarit bankare ka vlerësuar obligimet tatimore në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit 03/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat Neni 19, paragrafi 1, i cili nen citon:

1. Aty ku Drejtori i Përgjithshëm beson se informatat e siguruar nga një person në deklaratën tatimore nuk paraqesin në mënyrë të saktë detyrimin e tij tatimor, ose kur tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar me këtë ligj, Drejtori i Përgjithshëm 132 mund të bëjë një vlerësim të detyrimit të tij tatimor, përfshirë, por duke mos u kufizuar në, vlerësimet që rezultojnë nga përdorimi i faturave apo transaksioneve false. Përveç për rastet që përfshijnë vepra penale në fushën e tatimeve apo kur shuma e obligimit tatimor mund të përcaktohet deri në siguri të arsyeshme, vlerësimet sipas këtij paragrafi do të bëhen pas fillimit të procedurave të kontrollit sikurse janë përshkruar në nenin 14 të këtij ligji,, nëse procedurat e tilla kërkojnë. Kufizimi i vënë me këtë paragraf nuk do të aplikohet në dispozitat e nenit 21 të këtij ligji.

Tatimpaguesi gjatë procesit të kontrollit i ka plotësuar kushtet me qenë deklarues i TVSh-së nga data 24.01.2018, sipas Nenit 7 paragrafi 2 i Ligjit 05/L037, për TVSh-ë i cili nen citon;

2. Çdo person, i cili nuk e ka bërë njoftimin dhe regjistrimin me kohë, duhet të regjistrohet në mënyrë të detyrueshme nga ATK-ja me efekt retroaktiv qysh nga data e tejkalimit të pragut, sikur që është përkufizuar në paragrafin 1, të nenit 6 të këtij ligji.

Gjithashtu tatimpaguesi ka qenë i obliguar 10% të fitimit neto të kontribuoi në Fondin e Kursimeve Pensionale dhe me të drejtë kontrolli ka vlerësuar bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit 04/L – 101 për Fondin pensional të Kosovës Neni 6 paragrafi 12, i cili nen citojnë:

Personat e vetëpunësuar, të cilët paguajnë tatim mbi të ardhurat në të ardhura bruto dhe kanë ndalesa më të ulëta të lejueshme (para ndalesave për kontribut pensional) do të kontribuojnë me një shumë minimale prej 10% të asaj shume neto (me një kufi maksimal prej 30% të asaj shume neto).

Pretendimet e tatimpaguesit në ankesë se për veç të hyrave nuk është marrë si kosto asgjë – Divizioni i Ankesave vlerëson se kontrolli në mungesë të fakteve nuk ka pranuar kosto (blerje) me arsyetimin se nuk keni prezantuar evidencat kontabël për zbritje të ndonjë shpenzimi. Andaj Divizioni i Ankesave sipas paragrafit 6 të nenit 19 të Ligjit nr:03/L-222 tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi nga Drejtori i Përgjithshëm është i gabuar dhe barrën për të provuar se shuma e ndonjë vlerësimi të tillë është e pasaktë

Divizioni i Ankesave pas analizës së dokumentacionit në dosje vërteton se kontrolli gjatë përpilimit të deklaratës vjetore për periudhën 2018, te zëri 60 të Ardhurat Bruto në deklaratën vjetore e ka evidentua në total vlerën e deponimeve 49,092.42, pa e minusuar tvsh-në e llogaritur. Kalkulimi sipas Divizionit të Ankesave është kështu: Vlera totale e deponimeve 49,092.42 – 30,000.00 pragu i TVSh-së = 19,092.42 nga kjo vlerë e nxjerrim TVSh-në brenda me koeficientin 6,555, që na jep TVSh-në e llogaritur 2,912.40€, andaj vlera $19,092.42 - 2,912.40 = 16,180.01$ vlera e tatueshme .

Qarkullimi shtesë sipas D/A-ve, për periudhën 2018, për TAP duhet të jetë - 30,000.00 + 16,180.01 = 46,180.01, e jo sipas kontrollit 49,092.42

Gjithashtu D/A-ve bënë rregullimin edhe për periudhën 2019, te zëri 60 të Ardhurat Bruto në deklaratën vjetore e ka evidentua në total vlerën e deponimeve 3,900.17, pa e minusuar tvsh-në e llogaritur. Kalkulimi sipas Divizionit të Ankesave është kështu: Vlera totale e deponimeve 3,900.17 nga kjo vlerë e nxjerrim TVSh-në brenda me koeficientin 6,555, që na jep TVSh-në e llogaritur 594,94€, andaj vlera $3,900.17 - 594,94 = 3,305.22$ vlera e tatueshme .

Qarkullimi shtesë sipas D/A-ve, për periudhën 2019, për TAP duhet të jetë 3,305.22 e jo sipas kontrollit 3,900.17€.

Gjithashtu D/A-ve bënë rregullimin edhe për periudhën 2021, te zëri 60 të Ardhurat Bruto në deklaratën vjetore e ka evidentua në total vlerën e deponimeve 8,240.00, pa e minusuar tvsh-në e llogaritur. Kalkulimi sipas Divizionit të Ankesave është kështu: Vlera totale e deponimeve 8,240.00 nga kjo vlerë e nxjerrim TVSh-në brenda me koeficientin 6,555, që na jep TVSh-në e llogaritur 1,256.94€, andaj vlera $8,240.00 - 1,256.94 = 6,983.05$ vlera e tatueshme .

Qarkullimi shtesë sipas D/A-ve, për periudhën 2021, për TAP duhet të jetë 6,983.05 e jo sipas kontrollit 8,240.00€.

Në bazë të gjendjes së konstatuar duke pasur parasysh kontestin dhe të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 132, pika (4), të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L- 031, Divizioni i Ankesave e vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në Nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat” 03/L - 222, tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit (30) ditësh , nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave ,ta kundërshtojë këtë Vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr.460/2022 datë 15/12/2022

Vendimi t’iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi _____

Kryesuesi i panelit shqyrtues
Xhevdet Neziri _____

